VENDIM
Nr. 165, datë 15.5.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENER TRADE" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015. "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", si dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1249/6 prot., datë 12.5.2023, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Ener Trade' sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 24.4.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 429, seria F18, të shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.4.2023 dhe 26.4.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.5.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1249/5 prot., datë 11.5.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës.
- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria "Ener Trade" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 16, germat: "a", "b" dhe "c". Plotësuar;

Neni 16, pika 7. Plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 429, seria F18, të shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Ener Trade" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti